



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
RADIO TELEVISIONI SHQIPTAR

NJOFTIM PËR ANGAZHIMIN E KONSULENTIT TË JASHTËM

Radio Televizioni Shqiptar në zbatim të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 33 datë 31.07.2026 për angazhimin e konsulentëve të jashtëm me qëllim ndjekjen e procesit të transformimit institucional, fton të gjithë personat e interesuar të aplikojnë për angazhimin si:

“Konsulent i Jashtëm Juridik” me kontratë shërbimi

Dokumentacioni duhet të depozitohet pranë zyrës së Protokollit të RTSH-së ose aplikimit elektronik në adresën info@rtsh.al deri më 11 Gusht 2026.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatëve.

Aplikuesit të plotësojnë dhe dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

1. Formularin e vetëdeklarimit ([FORMULAR VETËDEKLARIMI](#))
2. Fotokopje e kartës së identitetit(ID);
3. Portofol Bashkëpunimi

Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë kërkesat e përgjithshme si dhe kërkesat e veçanta si më poshtë:

1. Kriteret e Përgjithshme Ligjore:

- Të jetë shtetas shqiptar
- Të mos ketë dënime penale: Duhet të dorëzojë dëshminë e penalitetit që vërteton se nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- Pa konflikt interesi: Nuk duhet të ketë lidhje apo interesa të drejtpërdrejta me projektin, kompanitë që konkurrojnë në të, apo me zyrtarët e institucionit që bëjnë përzgjedhjen.
- Të jetë i regjistruar rregullisht: Duhet të zotërojë NIPT aktiv (si person fizik ose studio juridike) për të faturuar shërbimin dhe për të paguar detyrimet tatimore.

2. Kriteret Profesionale dhe Eksperienca:

- Edukimi: Diplomë "Master i Shkencave" ose "Master Profesional" në Drejtësi (preferohen profilet e të Drejtës Publike, Ndërkombëtare ose Biznesit).
- Vitet e përvojës: Minimum prej 5 deri në 10 vjet përvojë pune si jurist/avokat, ku të jetë vlerësuar specifikisht në përvoja e ngjashme me objektin e projektit.

- Përvoja me institucione/donatorë: Përbën avantazh të madh nëse ka punuar më parë në projekte të financuara nga BE, BB, UNDP, ose projekte të tjera ndërkombëtare.
- Gjuhët e huaja: Zotërim i shkëlqyer i gjuhës angleze.

3. Dokumentacioni që duhet dorëzuar për Aplikim:

- CV e detajuar dhe letër motivimi ku shpjegohet përshtatshmëria me projektin.
- Kopje të diplomave, certifikatave dhe licencave
- Oferta Ekonomike.
- Deklaratë mbi konfliktin e interesit dhe vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.